



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E MIREMBAJTJES SE INFRASTRUKTURAVE DHE PUNEVE PUBLIKE
SEKTORI MBESHTETES

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 2
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Data 12.06.2024]

Drejtuar: [“ADA-CO” shpk me nipt K64112603J me adresë Korçe Pogradec, POGRADEC Zona Industriale, me administrator Z.Selvi Latifllari]

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedure e hapur-pune-elektronike”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-02351-04-23-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Mirëmbajtje e Institucioneve Shkollore me kohezgjatje 2 muaj/

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 22 datë 29 Prill 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “INA” shpk

J61814009W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **13,639,844.60** (trembedhjete milion e gjashtëqind e tridhjetë e nente mijë e teteqind e dyzet e kater pike gjashtedhjetë) **leke pa TVSH**

2. BOE "Infinit" shpk dhe “L.T.E Construction” shpk

J74304623M/

L78006801F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **17,028,091** (shtatembdhjetë milion e njezet e tete mijë e nentëdhjetë e nje) **leke pa TVSH.**

3. “ADA-CO” shpk

K64112603J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **17,680,590** (shtatembdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e nentëdhjetë) **leke pa TVSH.**

4. “REJ” shpk

J93711608Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **18,443,280** (tetembdhjetë milion e katerqind e dyzet e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë) **leke pa tvsh.**

5. “ASI INVEST” SHPK

M01927023H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **16,748,276** (gjashtembdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e tete mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) **leke pa TVSH.**

6. “SARK” shpk

K52531415H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **18,522,613** (tetembedhjete milion e peseqind e njetzet e dy mijë e gjashtëqind e trembedhjete) **leke pa TVSH.**

7. "Mela" shpk me NIPT K62320011G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: Nuk ka paraqitur formular oferte.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "INA" SHPK

Arsyet e mëposhtme:

Bazuar ne Ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" neni 27 "Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: "5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët", KVO refuzon oferten e "Ina" shpk si oferte anomalisht e ulët.

2. "Infinit" SHPK dhe "L.T.E Construction" shpk.

Arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1.Operatori ekonomik "Infinit" shpk ka deklaruar disponimin e punonjesve sipas Shtojces 8 te Formularit te Vetedeklarimit. Nga shtojca rezulton se OE ka deklaruar te njejtet punonjes si ne objektin e prokurimit: "Mirembajtje Kanali Ujites Leshnice" te zhvilluar nga AK NMIPP. Duke qene se OE eshte shpallur fitues ne kete objekt dhe objekti do te jete ne zbatim njekohesisht me objektin "Mirëmbajtje e Institucioneve Shkollore" e zhvilluar po nga AK NMIPP, OE Infinit shpk ka deklaruar te njejtet punonjes dhe drejtues Teknik, gje qe bie ndesh me rregullat e prokurimit publik dhe formularin e vetedeklarimit, ne te cilin operatori ka deklaruar se stafi Teknik do te jete i angazhuar dhe dispozicion vetem te nje objekti gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit.

Konkretisht OE "Infinit" shpk, njekohesisht ka deklaruar ne dy objekte te ndryshme prokurimi (ne njerin objekt i shpallur fitues), ne tjetrin ofertues ne proces, ku deklarone angazhimin e punonjesve te njejte si me poshte:

"...do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve. stafi teknik i poshtë shënuar: 1. **Znj.Valentina Bregu**,me profesion Ing. Ndertimi, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin, Ing.Ndertimi(Drejtues Teknik ne kete procedure) 2. **Z.Rediol Topalli**,me profesion Hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Hidraulik 3. **Z.Altin Elmasllari**,me profesion Bojaxhi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Bojaxhi 4. **Z.Renato Dajlani**,me profesion Pllakashtrues i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Pllakashtrues 5.**Z.Klajdi Kuqo**,me profesion Specialist Punime ne Lartesi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Specialist Punime ne Lartesi 6. **Z.Yllson Isuflari**,me profesion Specialist Punime ne Lartesi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Specialist Punime ne Lartesi 7. **Z.Fatmir Demollari**,me profesion Shofer, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Shofer."

2. Persa i perket anetarit tjetër të këtij BOE, **“L.T.E Construction”** shpk, rezulton se ky operator është në të njëjtën kohë subjekt mbështetës për OE **“Infinit”** shpk në objektin e prokurimit:

“Mirëmbajtje Kanali Ujites Leshnice” të zhvilluar nga AK NMIPP, në të cilin rezulton të ketë mbështetur me të njëjtin staf Teknik me stafin e deklaruar në këtë objekt prokurimi (Mirëmbajtje e Institucioneve Shkollore).

Konkretisht OE **L.T.E Construction** shpk, njëkohësisht ka deklaruar në dy objekte të ndryshme prokurimi (në njerin objekt i shpallur fitues), në tjetrin ofertues në proces, angazhimin e punonjësve të njëjtit si me poshtë:

“...do të jeni në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve. stafi teknik i poshtë shënuar: Z.Irvi Goxha, me profesion Pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sonë L.T.E CONSTRUCTION, në rolin e Pllakashtrues. Z.Avni Sulozeqi, i punësuar pranë shoqërisë sonë L.T.E CONSTRUCTION, në rolin e Punëtor i thjeshtë Z.Klaudjo Murataj, i punësuar pranë shoqërisë sonë L.T.E CONSTRUCTION, në rolin e Punëtor i thjeshtë Z.Leonard Rozi, i punësuar pranë shoqërisë sonë L.T.E CONSTRUCTION, në rolin e Punëtor i thjeshtë”.

Për sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 **“Për Prokurimin Publik”**, i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e BOE **“Infinit”** shpk dhe **“L.T.E Construction”** shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

3. “ASI INVEST” SHPK

Arsyet e mëposhtme:

Më datë 27.05.2024, pasi u bë vlerësimi nga anetaret e KVO-së dhe përpara se të vazhdohet me shpalljen paraprake të Njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), nga Kryetari i KVO-se u dergua një **“Kerkesë për paraqitje dokumentacioni”** operatorit të kualifikuar në vend të parë **“Asi Invest” shpk**, ku i kërkohej që: *“Bazuar në VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, neni 26 pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”* kërkojme paraqitjen e dokumentacionit fitues brenda datës 30.05.2024.

Brenda afatit të kërkuar Operatori ekonomik, i cituar mësipër nuk u paraqit për të dorëzuar dokumentacionin fizik pranë Autoritetit Kontraktor (AK), brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KVO në sistem. Ndodhur në kushtet që operatori ekonomik nuk është paraqitur për të dorëzuar dokumentacionin fizik, KVO-ja ka skualifikuar operatorin ekonomik.

4. “SARK” shpk

Arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.

- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.

- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1. OE "Sark" shpk ka paraqitur disa kontrata të ngjashme për permbushjen e kriterit nr.2.3.1 të DST.

1.1-Ka paraqitur kontratën për punë publike nr.2565 prot.date 20.10.2022 me objekt: "Permiresimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara, Bashkia Delvine" me vlerë **6,805,282** leke pa TVSH.

1.2-Ka paraqitur kontratën për punë publike me nr.764 prot date 25.03.2022 me objekt: "Rikonstrukcion i shkollës së fshatit Mesopotam" me vlerë **1,390,690** leke pa TVSH.

1.3-Ka paraqitur kontratën për punë publike me nr.2930 prot date 25.05.2021 me objekt: "Riparim objekte shkollore" me vlerë **3,033,574** leke pa TVSH.

1.4-Ka paraqitur kontratën për punë publike me nr.2791 prot date 18.09.2019 me objekt: "Shpenzime për lysterje meremetime, dizinfektim ambientesh Bashkia Prrenjas" me vlerë **6,159,755.83** leke pa TVSH

1.5-Ka paraqitur kontratën për punë publike me nr.8844/2 prot date 27.10.2022 me objekt: "Punime ndertimore në kuadër të rehabilitimit të qendres aktuale dhe ngritjes së infrastruktures" me vlerë **5,592,960** leke pa TVSH.

Ne kriterin 2.3.1 të Kapacitetit teknik kërkohe:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

-Për sa me sipër, asnjë nga kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk e kanë vlerën sa 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (9,827,174.5 pa TVSH).

-Vlera totale e punëve të kryera të paraqitura nga OE "Sark" shpk është **22,982,262** leke pa TVSH duke mos e plotësuar kriterin nr.2.3.1 germa b) pasi vlera totale e punëve të kryera duhet të jetë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht **39,308,698** leke pa TVSH.

Për sa me sipër operatori ekonomik "Sark" shpk nuk e përmbush kriterin nr.2.3.1 të kapacitetit teknik pasi nuk përmbush asnjë nga pikat e këtij kriteri.

2.OE "Sark" shpk ka paraqitur Bilancin e vitit 2021, dhe Bilancin e vitit 2022 me humbje në kundërshtim kjo me kriterin nr.2.2.2 të kapacitetit ekonomik: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta

e OE “SARK” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

5. “Mela” shpk

Arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

OE nuk ka paraqitur formular oferte dhe asnjë dokumentacion tjetër të kërkuar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “Mela” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**ADA-CO” shpk me nipt K64112603J me adresë Korce Pogradec, Pogradec, Zona Industriale, me administrator Z.Selvi Latifllari**], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **17,680,590** (shtatembdhjete milion e gjashtëqind e tetëdhjete mijë e pesëqind e nentëdhjete) **leke pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

* * *

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike* Bulevardi “Rreshit Çollaku”, Lagja: Nr.2, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO x

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Enton BERBERI